

VENDIM
Nr. 102, datë 9.5.2022

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 40, DATË 10.3.2022, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘LAJTHIZA INVEST’ SHA NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC ‘QAMI 1’, ME KAPACITET TË INSTALUAR 1.730 mw”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 53, pika 2, të ligjit nr. 144/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.5.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 608/3 prot., datë 28.4.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 40, datë 10.3.2022, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Lajthiza Invest’ sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Qami 1’, me kapacitet të instaluar 1.730 mw””,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 40, datë 10.3.2022, vendosi të licencojë shoqërinë “Lajthiza Invest” sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Qami 1”, me kapacitet të instaluar 1.730 mw, për një afat 30-vjeçar. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune nga marrja dijeni e këtij vendimi, shoqëria duhet të depozitonte në ERE kontratat e rinovuara të qirasë për gjithë territorin ku shtrihet projekti, përkatësisht me Bashkinë Fushë-Arrëz dhe Bashkinë Kukës ose çdo dokument tjetër që vërteton të drejtën e subjektit për të përdorur pronën në zonën e projektit që shtrihet te këto dy bashki.

- Me shkresën nr. 11/9 prot., datë 24.3.2022, ERE njoftoi shoqërinë për vendimin nr. 40/2022, duke i kujtuar edhe detyrimin për të plotësuar kushtet sikurse përcaktuar në vendim.

- Brenda afatit të përcaktuar në pikën 2, të vendimit nr. 40, datë 10.3.2022, me shkresën e datës 20.4.2022, shoqëria ka depozituar në ERE dokumentacion në lidhje me të drejtën e përdorimit të pronës në zonën që shtrihet në Bashkinë Fushë-Arrëz, si dhe aplikimin përkatës në lidhje me të drejtën e përdorimit të pronës që shtrihet në Bashkinë Kukës. Me depozitimin e këtij dokumentacioni, rezulton se shoqëria ka plotësuar pjesërisht kushtin e vendosur në pikën 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 40, datë 10.3.2022.

- Po ashtu, shoqëria ka depozituar aplikimin që ka bërë në *e-Albania*, datë 15.4.2022, drejtuar ZVRPP Kukës, në lidhje me regjistrimin e të drejtës së përdorimit të pronës në këtë bashki, ndaj do t’i lihet kusht që brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune nga marrja dijeni të depozitojë në ERE dokumentin që vërteton të drejtën e subjektit për të përdorur pronën në zonën e projektit që shtrihet në Bashkinë Kukës.

- Në nenin 53, pika 2, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se: përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, nëse ligji ose aktet nënligjore nuk parashikojnë një afat të caktuar për kryerjen e një veprimi procedural, organi publik që kryen procedurën cakton me vendim të veçantë një afat të arsyeshëm, sipas çështjes konkrete dhe në përputhje me parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit.”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2, e vendimit nr. 40, datë 10.3.2022, të Bordit të ERE-s, ndryshon dhe bëhet:

“2. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune nga marrja dijeni e këtij vendimi, shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentin që vërteton të drejtën e subjektit për të përdorur pronën në zonën e projektit që shtrihet në Bashkinë Kukës.”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti